



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3602/19 prot.

Datë 13.03.2025

V E N D I M
Nr. 366/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiovent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.03.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-20989-09-20-2024, me objekt: “Rikonstruksion i Kopshtit Nr.3, lagjia Nr.5”, me fond limit 69,751,108.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukes

Ankimues: BOE “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK me NIPT K48021210Q dhe K24218401K si dhe adresë: Kukes, Kolsh, Lagjia Todaj, Rruga Nacionale Kukes-Tirane Km5, Ndertese Nr.1

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kukes me adresë: Sheshi “Skenderbej”, lagjia Nr.5, Kukes

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Xhast” SHPK me NIPT K12512837I dhe adresë: Tirane, Njesia Bashkiake Nr.11, Rruga Don Bosko, Objekt me Zone Kadastrale Nr.8330, Pasuri me Nr.9/576

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24.09.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-20989-09-20-2024, me objekt: “Rikonstruksion i Kopshtit Nr.3, lagjia Nr.5”, me fond limit 69,751,108.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukes.

II.2. Në datën 10.10.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se në datën 21.11.2024, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH), si më poshtë:

-“KOMBEAS” SHPK	48,412,700	skualifikuar
-“RSM COMPANY” SHPK	49,688,356	skualifikuar
-RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN	53,220,033.09	skualifikuar
-“XHAËT” SHPK	53,565,426.76	kualifikuar
-“DENOLT” SHPK & “Llazo” SHPK	53,641,108	kualifikuar
-“AVDULI” SHPK	54,663,340	kualifikuar
-“LEON KONSTRUKSION” SHPK	59,934,058.67	kualifikuar
-“KACDEDJA” SHPK	62,036,080.65	kualifikuar
-“ERNIKU” SHPK	62,842,259.36	skualifikuar
-“GRAND GRUP” SHPK	65,615,259.73	skualifikuar
-“2N” SHPK	67,785,647.36	kualifikuar

II.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 04.12.2024, është publikuar njoftimi i fituesit paraprak.

II.5. Në datën 10.12.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4874 dhe me nr.3602 prot., datë 10.12.2024 e BOE “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-20989-09-20-2024, me objekt: “Rikonstruksion i Kopshtit Nr.3, lagjia Nr.5”, me fond limit 69,751,108.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3602/3 prot., datë 11.12.2024.

II.7. Në datë 27.12.2024 autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistem shkresën “ Dërgim Vendim i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave Nr.157, date 26.12.2024” por pa i bashkëlidhur shkresës

vendimin e KSHA për trajtimin e ankesës protokolluar me tonën me nr. 3602/4 prot., datë 27.12.2024.

II.8. Të njëjtën shkresë autoriteti kontraktor e dërgoi në KPP përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) për shkak të problemeve në sistem sipas tij, duke i bashkëngjitur edhe vendimin e KSHA-së me nr. 157, datë 26.12.2024 i cili u protokollua me tonën me nr. 3602/6 prot., datë 14.01.2025 dhe ku sipas këtij vendimi ka vendosur refuzimin e ankesës duke u shprehur se: "[...]III.Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) në mbledhjen e tij të datës 26.12.2024, nisur nga pretendimet e parashtruara nga operatori ankimues për mospermbushje nga ana e operatorit ekonomik "Xhast" SHPK të kriterëve si më poshtë:

1. Shtoja 1. Formulari i Ofertes
2. Shtojca 2. Listat e mimeve sipas zërave të preventivit
3. Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës
4. Shtojca 7: Formularet e Pershtatshmërisë dhe Kualifikimit të Ofertuesve , vendosi të verifikojë dokumentacionin e dorëzuar nga OE "Xhast" shpk në formatin elektronik (Sistemin e prokurimit elektronik) si dhe atë të dorëzuar fizikisht.

Nga verifikimi në SPE rezulton që OE "XHAST" SHPK, në përmbushje të kërkesave të përgjithshme dhe të vecanta të kërkuara nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës për procedurën me objekt: "Rikonstruksion i Kopshtit Nr.3, lagjia Nr.5" ka paraqitur ndër të tjera :

1. Formularin e ofertes të datës 10.10.2024 (Sht_1_dhe 2_Oferta_Ekonomike)2 flete, e cila përputhet plotësisht me formatin e kërkuar në dft dhe është e plotësuar në të gjitha rubrikat me të dhëna të sakta për procedurën në fjalë dhe gjithashtu oferta e ofruar përputhet si në numra ashtu dhe në shkrimin me fjalë të vlerës së ofertuar, konkretisht: (e) (mimi total i Ofertes sone, pa TVSH, është: 53,565,426.76[pesëdhjetë e tre milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e njëzet e gjashtë pike shtatëdhjetë e gjashtë]; (f) Çmimi total i Ofertes sone, me TVSH (përfshirë paisjet me TVSH), është: 68,414,612.11 [gjashtëdhjetë e tetë milion e katërqind e katërmbedhjetë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë pike njëmbëdhjetë].

Formulari i ofertes është i nënshkruar dhe vëlosur nga përfaqësuesi i ofertuesit.

2. Bashkëngjitur formularit të ofertes është dhe PREVENTIVI I OFERTES PËR OBJEKTIN : REHABILITIM I KOPSHTIT NR.3, LAGJIA 5, KUKËS" I cili përbehet nga 6 flete, është i plotësuar në të gjitha rubrikat e tij dhe qartazi përcaktohen zërat e punimeve që do të realizohen, sasitë dhe çmimin e tyre dhe ka përputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumezimi i çmimit për njësi me sasine. Formatin e përdorur është i njëjti me formatin e publikuar nga AK në SPE.Gjithashtu është i nënshkruar dhe vëlosur nga përfaqësuesi i ofertuesit në çdo faqe të tij.

- 3.Formulari i sigurimit të ofertes me Numer serial: 240607771 , datë 10.10.2024 i njëjti me formularin tip të kërkuar në dft sipas shtojcës 3, shuma e kërkuar e sigurimit të ofertes është 1.395.022 (një milion e treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëzet e dy)lek. Shuma e siguruar është 1.395.022 (një milion e treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëzet e dy) e netë me vlerën e kërkuar në DST.

4. Formularin përmbledhës të vetedeklarimit me datë dorëzimi të deklarates 10/10/2024.

Formular i cili este i plotesuar ne te giitha rubrikat me informacionin mbi kapacitetin, mjetet, fuqine puntore te nevojshme per plotesimin e kerkesave te kerkuara nga AK ne dst, eshte i njejte me formatin e publikuar nga AK ne dst dhe eshte i nenshkruar dhe vulosur ne te githa fletet e tij nga perfaqesuesi i ofertuesit.

KSHA gjithashtu verifikoi edhe dokumentat e dorezuara fizikisht nga OE "XHAŠT" SHPK, nga ku rezulton se dokumentacioni provues este i jejte me dokumentacioni e paragitur ne sistemin e prokurimit elektronik.

II.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave

Pas shqyrtimit te ankeses se paraqitur nga BOE "Denolt" SHPK dhe "Llazo" SHPK me numer ankimi elektronik A/2024/4874 dhe me nr.3602 prot., date 10.12.2024, sa me siper si dhe verifikimit te dokumentacionit te dosjes se prokurimit per proceduren me objekt: "Rikonstruksion i Kopshtit Nr.3, lagjia Nr.5", fond limit 69,751,108 leke (pa tvsh), Proçedure prokurimi: Procedur e Hapur, Nr. REF-20989-09-20-2024.

Ndodhur para rrethanave dhe fakteve te analizuara me siper, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave ingritur prane Bashkise Kukes, bazuar ne ligjin Nr.44/2015, te miratuar me date 30.04.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative ne RSH", ligjin Nr. 162/2020, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" (indryshuar), nenet 17, 42, 77, 92,112,114, VKM Nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e proçedurave te prokurimit publik" (indryshuar), nenet 43, 96,101,102.

VENDOSI:

1. Refuzimin e ankeses se paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik "Denolt" SHPK dhe "Llazo" SHPK me NIPT K48021210Q dhe K24218401K, per proceduren e prokurimit "E hapur", me Nr. REF-20989-09-20-2024, me objekt: "Rikonstruksion i Kopshtit Nr.3, lagjia Nr.5", me fond limit 69,751,108.00 leke pa TVSH, zhvilluar ne datën 10.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukes.

2.Nje kopje e ketij vendimi te dergohet nepermjet sistemit te ankesave elektronike te KPP-se. Ky vendim hyn ne fuge menjehere.

II.9. Në datën 10.12.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4875 dhe me nr.3602/1 prot., datë 11.12.2024 e BOE "Denolt" SHPK dhe "Llazo" SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar dhe nga verifikimi u konstatua se objekti i ankesës ishte i njëjtë me atë të ankesës së sipërcituar pra lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Xhast" SHPK.

II.10. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe u publikua formulari i publikimit.

II.11. Me shkresën me nr. 3602/7 prot., datë 15.01.2025 KPP ju drejtuar BOE ankimues me kërkesën për informacion si më poshtë: *“Në Sistemin e Ankesave Elektronike më datë 10.12.2024 janë paraqitur ankesat e ardhura nëpërmjet shërbimit e-Albania me numër ankimi elektronik A/2024/4874 dhe me nr.3602 prot., datë 10.12.2024, si dhe me numër A/2024/4875 dhe me nr.3602/1 prot., datë 10.12.2024 të BOE “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-20989-09-20-2024, me objekt: “Rikonstruksion i Kopshtit Nr.3, lagjia Nr.5”, me fond limit 69,751,108.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukes.*

Nga verifikimi paraprak rezulton se pavarësisht se ankesat janë paraqitur nga i njëjti ankimues dhe për të njëjtën procedurë prokurimi përmbajtja e tyre është e ndryshme. Gjithashtu nga verifikimet rezulton se është kryer pagesa e tarifës financiare vetëm për njëren prej ankesave.

Komisioni i Prokurimit Publik si organi më i lartë administrativ për shqyrtimin e ankesave që lidhen me procedurat e prokurimit publik brenda dy ditëve nga marrja e kësaj shkrese kërkon konfirmimin nga ana juaj si BOE ankimues se cila është ankesa që KPP duhet të marrë në shqyrtimin duke qenë se ato kanë përmbajtje të ndryshme dhe se për cilën prej tyre është kryer pagesa e tarifës financiare.

II.12. Përmes shkresës së datës 21.01.2025 me lëndë “Kthim përgjigje shkresës tuaj Nr. 3062/8 prot., datë 15.01.2025” dërguar përmes komunikimit elektronik zyrtar dhe protokolluar me tonën me nr. 3602/8 prot., datë 27.01.2025 BOE ankimues ka njoftuar KPP se: *“ Në lidhje me pyetjen tuaj se për cilën nga ankesat eshte kryer pagesa, ju konfirmojme se pagesa eshte kryer nga ana e shoqerise sone per ankesen e dyte te ngarkuar ne e-albania ankesa me numer ankimi elektronik A/2024/4875, datë 10.12.2024.”*

II.13. I njëjti informacion u dërguar në KPP edhe përmes shkresës nr. 719/1 prot., datë 26.01.2025 i cili u protokollua me tonën me nr. 3602/9 prot., datë 27.01.2025.

II.14. Me shkresën nr. 3602/10 prot., datë 27.01.2025 KPP ju drejtua autoritetit kontraktor me kërkesën për vënien në dispozicion të tij të dokumentave të dërguar fizikisht në autoritetin kontraktor nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari “Xhast” SHPK.

II.15. Me shkresën nr. 456 prot., datë 31.01.2025 protokolluar me tonën me nr.3602/11 prot., datë 05.02.2025 autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të KPP informacionin e kërkuar më sipër të operatorit ekonomik “Xhast” SHPK.

II.16. Me shkresën nr. 3602/12 prot., datë 11.02.2025 KPP ju drejtua me kërkesën për informacion autoritetit kontraktor si më poshtë: *“[...] Me shkresën nr. 456 prot., datë 31.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3602/11 prot., datë 05.02.2025 institucioni juaj ka dërguar pranë KPP informacionin e kërkuar përmes shkresës më sipër duke u shprehur se: “[...]Bashëngjitur kësaj shkrese ju dërgojmë: Dokumentacionin njesuar me origjinalin të dorëzuar nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK.”*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ana juaj nuk rezulton të jetë paraqitur lista e inventarit të dokumentave si dhe numri i faqeve apo i fletëve.

Sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na vini në dispozicion edhe një herë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK pranë institucionit tuaj të shoqëruar me informacion të detajuar mbi listën e dokumentave të dorëzuara nga ky operatori ekonomik, numrin e fletëve dhe faqeve të dokumentacionit të dorëzuar pranë institucionit tuaj dhe administruar në protokoll, gjithashtu nëse është mbajtur edhe procesverbalin e dorëzimit të dokumentacionit ndërmjet operatorit ekonomik dhe punonjësit të protokollit.”

II.17. Me shkresën nr. 3602/13 prot., datë 17.02.2025 KPP njoftoi sektorin e financës për kalimin e tarifës financiare te ankesa me numer ankimi elektronik A/2024/4875, datë 10.12.2024 dhe me nr.3602/1 prot., datë 11.12.2024 pasi vetë BOE ankimues kishte pranuar që pagesën e tarifës financiare e ka kryer për këtë ankesë.

II.18. Me shkresën nr. 456/2 prot., datë 24.02.2025 me lëndë “Dërgim dokumentacioni” protokolluar me tonën me nr. 3602/14 prot., datë 26.02.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar KPP se: *“Bazuar në kërkesën tuaj nr. 3602/12 prot., datë 11.02.2025 protokolluar me tonën me nr. 456/1 prot datë 14.02.2025 ju bëjmë me dije se operatori ekonomik “Xhast” SHPK ka sjellë dokumentat për tenderin me objekt “Rikonstruksion i Kopështit nr. 3 Lagjia nr. 5” me REF-20989-09-20-2024 me shkrse përcjellëse Nr.5252 prot datë 25.11.2024 pranë Bashkisë Kukës. Bashkëngjitur po ju dërgojmë dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK me informacionin e detajuar mbi listen e dokumenteve dhe numrin e fletëve dhe faqeve.”*

II.19. Me shkresën nr. 3602/15 prot., datë 27.02.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion” KPP ju drejtua autoritetit kontraktor me kërkesën si më poshtë:

“KPP me shkresën nr. 3602/10 prot. datë 27.01.2025 i ka kërkuar institucionit tuaj të dërgojë të plotë në origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK pranë autoritetit kontraktor si operator ekonomik i kualifikuar i pari sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Me shkresën nr. 456 prot., datë 31.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3602/11 prot., datë 05.02.2025 institucioni juaj ka dërguar pranë KPP informacionin e kërkuar përmes shkrësës më sipër duke u shprehur se: “[...]Bashkëngjitur kësaj shkrese ju dërgojmë: Dokumentacionin njësuar me origjinalin të dorëzuar nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK.”

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ana juaj nuk rezultoi të jetë paraqitur lista e inventarit të dokumentave si dhe numri i faqeve apo i fletëve por nga administrimi i këtij

dokumentacioni pranë KPP përmes shërbimit postar rezultoi se kishte një numër prej 274 faqesh.

Me shkresën nr. 3602/12 prot., datë 11.02.2025 KPP ka kërkuar nga institucioni juaj që të vihet në dispozicion edhe një herë dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK pranë jush i shoqëruar me informacion të detajuar mbi listën e dokumentave të dorëzuara nga ky operatori ekonomik, numrin e fletëve dhe faqeve të dokumentacionit të dorëzuar pranë institucionit tuaj dhe administruar në protokoll, gjithashtu nëse është mbajtur edhe procesverbalin e dorëzimit të dokumentacionit ndërmjet operatorit ekonomik dhe punonjësit të protokollit.

Me shkresën nr. 456/2 prot., datë 24.02.2025 me lëndë: “Dërgim dokumentacioni” protokolluar me tonën me nr. 3602/14 prot., datë 26.02.2025 ju keni dërguar në KPP dokumentacionin e kërkuar më sipër ku shpreheni se: “Bazuar në kërkesën tuaj Nr. 3602/12 prot., datë 11.02.2025, protokolluar me tonën Nr. 465/1 prot datë 14.02.2025 ju bëjmë me dije se operatori ekonomik “Xhast” SHPK ka sjellë dokumentat për tenderin me objekt “Rikonstruksion i Kopeshtit nr. 3, Lagjia Nr.5 me Nr. REF-20989-09-20-2024, me shkresë përcjellëse Nr. 5252 prot datë 25.011.2024 pranë Bashkisë Kukës. Bashkëngjitur po ju dërgojmë dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK me informacionin e detajuar mbi listën e dokumentave dhe numrin e faqeve dhe fletëve.”

Nga verifikimet i dokumentacionit të dërguar nga ana juaj vihet re se operatori ekonomik “Xhast” SHPK përmes shkresës përcjellëse të datës 25.11.2024 ka listuar dokumentat e dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor pa numër faqesh ndërsa në shkresën tuaj me nr. 456/2 prot., datë 24.02.2025 me lëndë: “Dërgim dokumentacioni” protokolluar me tonën me nr. 3602/14 prot., datë 26.02.2025 ju keni listuar dokumentat dhe numrin e faqeve i cili nuk përputhet me numrin e faqeve të dokumentacionit të administruar në zyrën e protokollit të KPP-së ku ky dokumentacion rezulton në një numër prej 732 faqesh.

Sa më sipër duke qënë se rezulton të jenë dërguar pranë KPP dy shkresa me dokumentacionin e operatorit ekonomik “Xhast” SHPK të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor si operator ekonomik i kualifikuar i pari por ato përmbajnë numër të ndryshëm faqesh, (e para 274 faqe dhe e dyta 732 faqe) ju duhet të na informoni pse ka ndryshim në numrin e faqeve të dokumentacionit të dërguar nga ana juaj si dhe të na konfirmoni në mënyrë përfundimtare numrin e faqeve të dokumentacionit të paraqitur pranë jush nga ky operator ekonomik i shoqëruar nëse është mbajtur edhe me procesverbalin e dorëzimit të dokumentacionit ndërmjet operatorit ekonomik dhe punonjësit të protokollit.”

II.20. Me shkresën nr. 1331 prot., datë 06.03.2025 protokolluar me tonën me nr. 3602/16 prot., datë 10.03.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar KPP si vijon: “Në pergjigje te shkresës tuaj nr.3602/15 prot. date 27.02.2025 ne te cilën kërkohet qe t'ju informojmë pse ka ndryshim në numrin e faqeve te dokumentacionit te dërguar nga ana jonë me shkresën nr.456 prot. date

31.01.2025 , nje material prej 274 faqesh , dhe me shkresën nr.456/2 prot. datë 24.02.2025 një dokumentacion prej 732 faqesh, ju informojme si më poshtë:

Me shkresën nr.456/2 prot , datë 24.02.2025 me lënde: “Dërgim dokumentacioni”, Bashkia Kukës ka dërguar dokumentacionin e plotë të njehsuar me origjinalin e dokumentave te dorëzuar nga operatori ekonomik “Xhast” shpk për procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i Kopshtit nr.3, Lagjia nr.5. Dokumentacion i cili ka në përbërje një numër prej 732 faqesh. Konfirmojmë se dokumentacioni i dërguar prej 732 faqesh **eshte i sakte dhe i plote.**

Ndërsa material i dërguar prej 274 faqesh edhe pse i printuar në te dyja anët e fages nuk ka qenë i plotë dhe kjo ka ardhur si pasojë e keqfunksionimit të makinerise fotokopjuese të përdorur për fotokopjimin e materialit te kërkuar.”

II.21. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të LPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK me datë 10.12.2024 me numër ankimi elektronik A/2024/4874 dhe me nr.3602 prot., datë 10.12.2024 para shqyrtimit në themel të saj KPP gjen me vend të sqarojë se kjo ankesë lidhet me procedurën e prokurimit të sipërcituar për të cilën është paraqitur dhe një tjetër ankesë nga i njëjti BOE ankimues por me përmbajtje të ndryshme konkretisht ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4875 dhe me nr.3602/1 prot., datë 11.12.2024. Me shkresën me nr. 3602/7 prot., datë 15.01.2025 KPP ju drejtuar BOE ankimues me kërkesën për informacion si më poshtë: “Në Sistemin e Ankesave Elektronike më datë 10.12.2024 janë paraqitur ankesat e ardhura nëpërmjet shërbimit e-Albania me numër ankimi elektronik A/2024/4874 dhe me nr.3602 prot., datë 10.12.2024, si dhe me numër A/2024/4875 dhe me nr.3602/1 prot., datë 10.12.2024 të BOE “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-20989-09-20-2024, me objekt: “Rikonstruksion i Kopshtit Nr.3, lagjia Nr.5”, me fond limit 69,751,108.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukes.Nga verifikimi paraprak rezulton se pavarësisht se ankesat janë paraqitur nga i njëjti ankimues dhe për të njëjtën procedurë prokurimi përmbajtja e tyre është e ndryshme. Gjithashtu nga verifikimet rezulton se është kryer pagesa e tarifës financiare vetëm për njërën prej ankesave. Komisioni i Prokurimit Publik si organi më i lartë administrativ për shqyrtimin e ankesave që lidhen me procedurat e prokurimit publik brenda dy ditëve nga marrja e kësaj shkrese kërkon konfirmimin nga ana juaj si BOE ankimues se cila është ankesa që KPP duhet të

marrë në shqyrtimin duke qenë se ato kanë përmbajtje të ndryshme dhe se për cilën prej tyre është kryer pagesa e tarifës financiare.”

Përmes shkresës së datës 21.01.2025 me lëndë “Kthim përgjigje shkreses tuaj Nr. 3062/8 prot., datë 15.01.2025” dërguar përmes komunikimit elektronik zyrtar dhe protokolluar me tonën me nr. 3602/8 prot., datë 27.01.2025 BOE ankimues ka njoftuar KPP se: *“Në lidhje me pyetjen tuaj se për cilën nga ankesat është kryer pagesa, ju konfirmojme se pagesa është kryer nga ana e shoqërisë sone për ankesën e dytë të ngarkuar në e-albania ankesa me numer ankimi elektronik A/2024/4875, datë 10.12.2024.”* Gjithashtu nga verifikimet e kryera rezulton se ankimuesi ka bashkëngjitur të njëjtin mandat pagesë për të dy ankesat. Në këtë kuadër duke qenë se përmes informacionit më sipër ankimuesi ka pranuar se pagesa është kryer për ankesën me nr. A/2024/4875, datë 10.12.2024 dhe nr. 3602/1 prot., datë 11.12.2024 KPP do të kalojë pagesën nga ankesa me nr. ankimi elektronik A/2024/4874 datë 10.12.2024 dhe me nr. 3602 prot., datë 11.12.2024 te ankesa me nr. A/2024/4875, datë 10.12.2024 dhe nr. 3602/1 prot datë 11.12.2024 duke ndryshuar edhe statusin e pagesës së kësaj të fundit nga “pa paguar mandat pagesë” në “paguar mandat pagesë” dhe si rrjedhim do të marrë në shqyrtim këtë ankesë.

III.2. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura përmes ankesës me nr. A/2024/4875, datë 10.12.2024 dhe nr. 3602/1 prot datë 11.12.2024, (thema decidendum) në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se *“1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”*, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës së paraqitur nga BOE ankimues “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK ka lidhje me veprimet e tjera të autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.3. Marrë shkas nga pretendimet e BOE ankimues “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK , për skualifikimin e operatorit ekonomik “Xhast ” SHPK nga procedura e prokurimit me arsyen, se

“II) Nuk përmbush kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3.5:

5. Punonjësit e mëposhtëm të paraqitur nga operatori i shpallur fitues nuk janë të diplomuar/certifikuar si specialist, nga një organ shtetëror apo privat i licencuar apo akredituar sipas legjislacionit në fuqi për të diplomuar këta punonjës sipas specialiteteve të kërkuara:

Punonjës Staf Teknik

- Teknik ndertimi 1 (nje)

- Hidraulik 2 (nje)

- Elektracist 1 (nje)

- Murator 2 (dy)
- Hekurthyes 1 (nje)
- Punëtorë te thjeshtë 35 (tridhjetë e pesë)
- Punëtor lartësie 2 (dy)

III) Nuk permbush kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 2.3.6 pasi:

6. Punonjesi 1 (një) Çertifikatë si Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë nuk është leshuar nga një subjekt/institucion i licencuar apo i akredituar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV) Nuk permbush kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 2.3.9 pasi:

7. Dokumentat e dorezuara për Aparat Troketimi nuk kanë të bëjnë me Aparatin e Troketimit por me pajisje tjeter që nuk është për të njëjtin funksion. Kujtojmë se Aparati i troketimit nuk ka lidhje funksionale me pompat e suvatimit. Te behen verifikimet perkatese.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.5, 2.3.6 dhe 2.3.9 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë leshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

Punonjës Staf Teknik

- Ing. Ndertimi 1 (nje)
- Teknik ndertimi 1 (nje)
- Hidraulik 2 (nje)
- Elektracist 1 (nje)
- Murator 2 (dy)
- Hekurthyes 1 (nje)
- Punëtorë te thjeshtë 35 (tridhjetë e pesë)
- Punëtor lartësie 2 (dy)
- Shofer 2 (dy)
- Manovrator 1 (nje)

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV
- Kontrate pune

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

2.3.9 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
3	Aparat troketimi	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
4	Vinc kulle	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
5	Autovinç deri 2.5 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
6	Betoniëre	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	3
7	Vibrator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
8	Matrapik	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	3
9	Depozita uji deri 1000 liter	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
10	Elektroda te zakonshme	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1

11	Saldatrice elektrike	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
12	Skeleri	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	m ²	1100

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:
 - dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë);
 - leje qarkullimi;
 - çertifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme);
 - siguracion mjeti (i vlefshëm);
 - çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet:
 - kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi;
 - dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)
 - leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
 - siguracion mjeti (i vlefshëm);
 - çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- e. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- f. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

III.3.2. Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, Pjesa III “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit” pika B “**DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”**”, dhe pika C “**DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”**” autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:	Punonjës
Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po [] Jo []
	Nëse, po, numri i punonjësve
	Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:
	1. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,
	2. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,
	3. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,
	Makineri e mjete
	Po [] Jo []
	Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të më vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si më poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				
Me qira				

Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					
Kontratë furnizimi					
Materiali/prod ukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera		
1.					
2					
3					
4					

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohe për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.3.6. “Në nenin 26 pika 2 dhe 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

- a) *operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) *operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të

provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

III.3.8. Nisur nga pretendimet më sipër të BOE ankimues, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Xhast” SHPK, duke qenë se operatori ekonomik “Xhast” SHPK, sipas vendimit të KVO-së është operatori ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duhet të paraqiste pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në pikën 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Duke qenë se pretendimet e BOE ankimues lidhen me një grup kriteresh të veçanta të kualifikimit (me punonjësit dhe pajisjet (aparatin e troketimit) të cilat fillimisht plotësohen përmes formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe me pas operatori ekonomik i kualifikuar i pari para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit i dorëzon dokumentet provues të deklarimeve në autoritet kontraktor, KPP me shkresën nr.3602/10 prot, datë 27.01.2025 i kërkoi autoritetit kontraktor të dërgojë në KPP të plotë në origjinal ose kopje të njëzuar me origjinalin dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK pranë autoritetit kontraktor si operator ekonomik i kualifikuar i pari sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me qëllim që pas verifikimit të dokumentacionit të mund shprehej mbi pretendimet e BOE ankimues.

Me shkresën nr. 456 prot., datë 31.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3602/11 prot., datë 05.02.2025 autoriteti ka dërguar pranë KPP informacionin e kërkuar përmes shkresës më sipër duke u shprehur se: “[...] Bashëngjitur kësaj shkrese ju dërgojmë: Dokumentacionin njëzuar me origjinalin të dorëzuar nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK.” Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor nuk rezultoi të jetë paraqitur lista e

inventarit të dokumentave si dhe numri i faqeve apo i fletëve por nga administrimi i këtij dokumentacioni pranë KPP përmes shërbimit postar rezultoi se kishte një numër prej 274 faqesh.

Duke qenë se sipas dokumentacionit të dërguar në KPP sipas shkresës më sipër nuk rezultoi të jetë paraqitur lista e inventarit të dokumentave si dhe numri i faqeve apo i fletëve, KPP përmes shkresës me nr. 3602/12 prot., datë 11.02.2025 ka kërkuar nga autoriteti kontraktor që të vihet në dispozicion edhe një herë dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK pranë tij me informacion të detajuar mbi listën e dokumentave të dorëzuara nga ky operator ekonomik, numrin e fletëve dhe faqeve të dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe administruar në protokoll, gjithashtu nëse është mbajtur edhe procesverbalin e dorëzimit të dokumentacionit ndërmjet operatorit ekonomik dhe punonjësit të protokollit.

Me shkresën nr. 456/2 prot., datë 24.02.2025 me lëndë: “Dërgim dokumentacioni” protokolluar me tonën me nr. 3602/14 prot., datë 26.02.2025 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP dokumentacionin e kërkuar më sipër ku shprehet se: *“Bazuar në kërkesën tuaj Nr. 3602/12 prot., datë 11.02.2025, protokolluar me tonën Nr. 465/1 prot datë 14.02.2025 ju bëjmë me dije se operatori ekonomik “Xhast” SHPK ka sjellë dokumentat për tenderin me objekt “Rikonstruksion i Kopeshtit nr. 3, Lagjia Nr.5 me Nr. REF-20989-09-20-2024, me shkresë përcjellëse Nr. 5252 prot datë 25.01.2024 pranë Bashkisë Kukës. Bashkëngjitur po ju dërgojmë dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK me informacionin e detajuar mbi listën e dokumentave dhe numrin e faqeve dhe fletëve.”*

Nga verifikimet i dokumentacionit të dërguar nga autoritet kontraktor vihet re se operatori ekonomik “Xhast” SHPK përmes shkresës përcjellëse të datës 25.11.2024 ka listuar dokumentat e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor pa numër faqesh ndërsa në shkresën e autoritetit kontraktor me nr. 456/2 prot., datë 24.02.2025 me lëndë: “Dërgim dokumentacioni” protokolluar me tonën me nr. 3602/14 prot., datë 26.02.2025 autoriteti kontraktor përmes shkresës përcjellëse ka listuar dokumentat dhe numrin e faqeve i cili nuk përputhej me numrin e faqeve të dokumentacionit të administruar në zyrën e protokollit të KPP-së ku ky dokumentacion rezultoi në një numër prej 732 faqesh.

Për këtë, meqenëse rezultoi se ishin dërguar pranë KPP dy shkresa me dokumentacionin e operatorit ekonomik “Xhast” SHPK të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor si operator ekonomik i kualifikuar i pari por ato përmbanin numër të ndryshëm faqesh, (e para 274 faqe dhe e dyta 732 faqe) ku duhet theksuar se ky numër në shkresën e dytë ndryshonte në mënyrë të ndjeshme nga e para, KPP përmes shkresës nr. 3602/12 prot., datë 27.02.2025 i kërkoj autoriteti kontraktor informacion pse ka ndryshim në numrin e faqeve të dokumentacionit të dërguar nga ai në KPP si dhe të konfirmonte në mënyrë përfundimtare numrin e faqeve të dokumentacionit të paraqitur pranë tij nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK i shoqëruar nëse është mbajtur edhe me procesverbalin e dorëzimit të dokumentacionit ndërmjet operatorit ekonomik dhe punonjësit të protokollit.

Në përgjigje të kërkesës më sipër të KPP-së autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1331 prot., datë 06.03.2025 me lëndë “Kthim përgjigje” ka njoftuar KPP se: “[...] Me shkresën nr.456/2 prot , datë 24.02.2025 me lëndë: “Dërgim dokumentacioni”, Bashkia Kukës ka dërguar dokumentacionin e plotë të njehsuar me origjinalin e dokumentave të dorëzuar nga operatori ekonomik “Xhast” shpk për procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i Kopshtit nr.3, Lagjia nr.5. Dokumentacioni i cili ka në përbërje një numër prej 732 faqesh. Konfirmojmë se dokumentacioni i dërguar prej 732 faqesh është i sakte dhe i plote. Ndërsa material i dërguar prej 274 faqesh edhe pse i printuar në të dyja anët e faqes nuk ka qenë i plotë dhe kjo ka ardhur si pasojë e keqfunksionimit të makinerise fotokopjuese të përdorur për fotokopjimin e materialit të kërkuar.”

Nisur nga pretendimet e BOE ankimues “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK duke qenë se ato lidheshin me punonjësit dhe pajisjet (aparatin e troketimit) të cilat fillimisht operatorët ekonomikë i deklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe më pas operatori ekonomik i kualifikuar i pari ka detyrimin që dokumentacionin provues të deklaruar në këtë formular ta paraqesë në autoritet kontraktor para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, KPP-së i duhet të verifikonte dokumentacionin fizik të dërguar nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK në autoritet kontraktor me qëllim që pas verifikimit të dokumentacionit të mund shprehej mbi pretendimet e BOE ankimues. Siç jemi shprehur më sipër në këtë vendim rezultoi se ishin dërguar pranë KPP dy shkresa me dokumentacionin e operatorit ekonomik “Xhast” SHPK të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor si operator ekonomik i kualifikuar i pari të cilat përmbanin numër të ndryshëm faqesh, (e para 274 faqe dhe e dyta 732 faqe) numër ky me një diferencë të ndjeshme faqesh mes dy shkresave. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar në KPP prej 732 faqesh rezultoi se ishin përfshirë shumë dokumenta të cilët nuk ishin listuar dhe as nuk përfshiheshin në dokumentacionin e dorëzuar prej 274 faqesh. Konkretisht mund të evidentojmë që në dokumentacionin prej 732 faqesh jo vetëm që nuk ishte dërguar dokumentacioni që do të shërbente KPP për të verifikuar pretendimet e BOE ankimues mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Xhast” SHPK por edhe shumë dokumenta të tjerat të cilët rezultojnë në shkresën e dytë. Specifikisht evidentojmë disa prej dokumentave shtesë të dorëzuara në dokumentacionin prej 732 faqesh si vijon: Shkresa përcjellëse e operatorit ekonomik “Xhast” SHPK e datës 25.11.2025 me listimin e akteve pa numër faqesh; dokumentacioni mbi makineritë të përcaktuar në pikën 2.3.9 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, dokumentacioni mbi disponueshmërinë e stafit teknik (jo inxhinierik) të përcaktuar në pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta të kualifikimit si dhe dokumentacioni për përmbushjen e pikës 2.3.6 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, Vertetim për statusin aktiv me nr. T11548529 datë 03.10.2024, Vertetim i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me nr. 15 prot., datë 04.10.2024, Vërtetim i gjendjes gjyqësore me nr. kërkesë 19, datë 02.10.2024, Vërtetim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë i datës 03.10.2024, Vërtetim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës i datës 07.10.2024, Vërtetim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës i datës 07.10.2024, Vërtetim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë i datës 03.10.2024.

Sic kemi evidentuar më sipër në këtë vendim, përveçse shkresa përcjellëse e operatorit ekonomik “Xhast” e datës 25.11.2024 listonte aktet pa numër faqesh, gjithashtu edhe në shkresën e autoritetit kontraktor me nr. 456/2 prot., datë 24.02.2025 me lëndë: “Dërgim dokumentacioni” protokolluar me tonën me nr. 3602/14 prot., datë 26.02.2025 (shkresën përcjellëse) janë listuar dokumentat e operatorit ekonomik “Xhast” SHPK të dërguara në KPP si dhe numri i faqeve të cilat nga mbledhja rezultojnë të jenë në një numër shumë herë më të lartë se ai i dokumentave të dërguar fizikisht në zyrën e protokollit të KPP-së ku kemi theksuar se ky dokumentacion rezulton në një numër prej 732 faqesh.

Gjithashtu është e rëndësishme të nënvizojmë se në asnjërën prej shkresave përmes të cilave autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP dokumentacionin e operatorit ekonomik “Xhast” SHPK **nuk ka paraqitur procesverbalin që duhej mbajtur ndërmjet operatorit ekonomik dhe punonjësit të protokollit për dorëzimin e dokumentacionit apo inventarizimi i akteve nga zyra e protokollit nëse dokumentacioni do përcillej përmes shërbimit postar** në përputhje me parashikimet e nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

III.3.9. Për sa më sipër, bazuar në faktet dhe informacionin e depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik rezulton se:

Së pari, Komisioni i Prokurimit Publik vëren parregullsi procedurale lidhur me administrimin e dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, pasi referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë dokumentuar aktet (të listuara dhe me numër faqesh) përmes procesverbalit që duhej mbajtur ndërmjet operatorit ekonomik dhe punonjësit të protokollit për dokumentet e dorëzuara në autoritet kontraktor apo inventarizimi i akteve nga zyra e protokollit nëse dokumentacioni do përcillej përmes shërbimit postar në përmbushje të parashikimeve të nenit 26 pika të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit publik” i ndryshuar, **si një aspekt shumë i rëndësishëm procedural i cili nëse nuk kryhet apo kryhet jo në mënyrën e duhur ndikon në ecurinë e mëtejshme të hetimit administrativ dhe në vetë shqyrtimin e ankesës.**

Së dyti, Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon faktin se një ndër risitë kryesore të ndryshimit të ligjit të prokurimit publik dhe hyrjes në fuqi të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, është edhe ai i plotësimit të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit si dhe të një grupi kriteresh të veçanta të kualifikimit përmes formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Ndërkohë, për operatorin ekonomik të kualifikuar të parin qëndron barra e provës për të vërtetuar edhe me dokumentacion shkresor pranë autoritetit kontraktor në përputhje me parashikimet e nenit 26, pika 6 të Vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Ndaj me rregullat e prokurimit publik janë përcaktuar edhe afate strikte dhe veprime procedurale të cilat duhet të ndiqen nga autoriteti kontraktor në procesin e verifikimit të vetëdeklarimit të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Ndër rregullat

strikte është ai i njoftimit të operatorit ekonomik të kualifikuar i pari mbi detyrimin për të dorëzuar dokumentacionin në përmbushje të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe verifikimit të këtij dokumentacioni para se ky i fundit të shpallet fitues nga ana e autoritetit kontraktor.

Referuar seksionit “Kërkesa” në SPE rezulton, se autoriteti kontraktor ka kryer në përputhje me parashikimet e mësipërme këtë procedurë por ndërkohë rezulton, se me veprime dhe mosveprime të autoritetit kontraktor, nuk mund të vërtetohet gjendja faktike e dokumenteve të dorëzuara në zyrën e protokollit nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK brenda afateve të përcaktuara ligjore si në lidhje me aktet e dorëzuara, por gjithashtu edhe në lidhje me numrin e fletëve të akteve të dorëzuara në kuadër të veprimeve procedurale të pranimin dhe të verifikimit të dokumentacionit.

Së treti, në thelb, pranë KPP-së është administruar informacion jo i qartë dhe evaziv mbi dokumentacionin e dorëzuar brenda afati ligjor nga operatori ekonomik pranë autoritetit kontraktor, ku nuk vërtetohet përmes asnjë dokumenti provues nëse ky i fundit është 274 faqe, apo 732 faqe pavarësisht pohimeve të pa provuara të autoritetit kontraktor se dokumentacioni i saktë dhe përfundimtar është ai prej 732 faqesh.

Në këto kushte, duke u kthyer tek ankesa e BOE ankimues, referuar dokumentacionit të administruar, për shkak të pasaktësive dhe shkeljeve procedurale të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të gjykojë dot mbi pretendimet e BOE ankimues, si dhe të verifikojë dokumentacionin në përmbushje të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK për një grup kriteresh të vecanta të kualifikimit. Në këtë rast veprimet procedurale të ndjekura nga autoriteti kontraktor të padokumentuara përmes një procesverbali, nuk janë transparente dhe në çdo rast mund të krijojnë dyshime lidhur me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik, të cilat do të shërbenin më pas për shqyrtimin e pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues. KPP konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka treguar kujdesin e duhur në lidhje me administrimin e dokumentacionit të dorëzuar, si dhe përcjelljen e informacionit KPP-së.

KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.3.10. Sa më sipër, mungesa e transparencës lidhur me hapat proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor, për sa i përket administrimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit, dhe krijon hapësirë për vlerësim subjektiv.

KPP nënvizon, se në respekt të parimit të transparencës, mosdiskriminimit dhe barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve, jo vetëm kriteret e kualifikimit, por edhe procedurat verifikuese të ndjekura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të mirëpërcaktuara nga autoriteti kontraktor, me qëllim që të jenë sa më të kuptueshme dhe transparente, jo vetëm për operatorët ekonomikë të interesuar për të qenë pjesëmarrës, por edhe për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave dhe Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave, në mënyrë të tillë, që procesi i vlerësimit të kryhet në trsansparencë të plotë dhe jo me subjektivizëm; si dhe të vendosë në situatë të barabartë të gjithë ofertuesit, duke rritur besimin e subjekteve në një procedurë prokurimi. KPP sqaron, se ndër qëllimet kryesore të ligjit të prokurimit publik është edhe ai i sigurimit të integritetit, besimit të publikut dhe transparencës në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

III.3.11. Në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji përcaktohet shprehimisht: *“Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”*. Në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]*”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se procesi i administrimit, trajtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në përmbushje të formularit të vetëdeklarimit, për një grup kriteresh të vecanta të kualifikimit mbi të cilat ankimuesi mbështet pretendimet e tij është bërë jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, pasi mungojnë dy elemente të rëndësishme, transparenca dhe provueshmëria, ndaj, përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.3.12 Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në dosje bazuar në nenin 23 “Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, KPP gjykon, se duhet t’i propozohet Agjencisë së Prokurimit Publik nisja e hetimit administrativ në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Xhast” SHPK, në zbatim të pikës 6, të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

III.4. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Xhast” SHPK me arsyen se: *“Nga eksperiencia qe kemi ne fushen e ndertimit dhe pjesmarrjes neper*

procedura prokurimesh, na ka rezultuar se operatorët ekonomik në përgjithësi kryejnë gabime aritmetike të tilla që çojnë në vlera totale tej asaj të ofertuar me të mëdha se vlera totale pa TVSH dhe rrjedhimisht edhe të totalit me TVSH. Në rastin konkret, kemi indicia se oferta e operatorit ekonomik ka gabime aritmetike të tilla që nëse do të korrigjohen oferta jep një vlerë totale mbi atë të publikuar nga A-K. Dalim në këtë konkluzion pasi edhe përlogaritjet tona aritmetike dhe diferenca midis ofertes së shpallur fituese na i jep këtë indicia. Oferta totale e analizës së ndertimit pa TVSH duhet të përfshijë edhe vlerën e pajisjeve. 4. Nëse gabimi do konstatohet atëherë oferta jone del e para fituese.” për ekonomi në procesin e shqyrtimit administrativ ai nuk do të merret në shqyrtim pasi referuar arsyetimit më sipër të KPP-së procedura e prokurimit do të anulohet dhe ankimesi nuk ka më interes të ligjshëm mbi pretendimet e tjera.

III.5. Për ankesën me nr. ankimi elektronik A/2024/4874 datë 10.12.2024 dhe me nr. 3602 prot., datë 11.12.2024 bazuar në arsyetimin më sipër KPP do të konsiderohet si ankesë pa pagesë duke mos plotësuar një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kjo ankesë duhet refuzuar.

Sa më lart ankesa me nr. ankimi elektronik A/2024/4874 datë 10.12.2024 dhe me nr. 3602 prot., datë 11.12.2024 nuk pranohet.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën me numër ankimi elektronik A/2024/4875 datë 10.12.2024 dhe me nr. 3602/1 prot., datë 11.12.2024 të BOE ankimues “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-20989-09-20-2024, me objekt: “Rikonstruksion i Kopshtit Nr.3, lagjia Nr.5”, me fond limit 69,751,108.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.
2. Të mos pranojë ankesën me numër ankimi elektronik A/2024/4875 datë 10.12.2024 dhe me nr. 3602 prot., datë 10.12.2024 të BOE ankimues “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. T'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në këtë shqyrtimin administrativ.
 6. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE ankimues "Denolt" SHPK dhe "Llazo" SHPK.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

